









ndari 2014










ti De Rada 2014



Ministria e Kulturës, me rastin e 200-vjetorit të lindjes së poetit dhe rilindësit të madh Jeronim De Rada, pati nderin ta shpallë vitin 2014 “Viti De Rada”. Në këtë kalendar janë përfshirë të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar dhe do të zhvillohen në Shqipëri me këtë rast. Protagonistë të tjerë e bashkëpunëtorë të vyer, falë të cilëve ekziston ky kalendar aktivitetesh, janë Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Elbasanit, Katedra e Albanologjisë në Mynih, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Akademia e Shkencave të Kosovës, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Universiteti “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, Universiteti “Fan Noli” në Korçë, Universiteti “Ismael Qemali” në Vlorë, shtëpia botuese “Çabej”, shtëpia botuese “Princi”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Universiteti i Kalabrisë, Universiteti i Kozencës, si dhe dy studiuesit e shkëlqyer arbëreshë, Prof. Matteo Mandala dhe Prof. Francesco Altimari. Ministria e Kulturës kontribuon qysh në krye me krijimin e Komitetit të Veprimtarive Kombëtare me rastin e 200-vjetorit të lindjes së De Radës, me botimin e veprës së tij të plotë e më tej me konkursin kombëtar të esesë për të rinj, “Unë, Milosao”. Po ashtu, Ministria e Kulturës ka rolin e vet të rëndësishëm në pjesëmarrjen, promovimin e këtyre aktiviteteve dhe mbarëvajtjen e këtij kalendari.

Data	Qyteti	Aktiviteti	Vendi i organizimit
 23.04.2014	 Tiranë	Promovimi i monografisë së Prof. Arshi Pipës për Jeronim De Radën në Ditën Botërore të Librit. Ky libër botohet për herë të parë në gjuhën shqipe dhe është botuar nga Botimet “Princi” – Organizator i këtij eventi ishte Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë në Universitetin e Tiranës.	Tiranë
 23.04.2014	 Tiranë	Dramatizimi i veprës më të famshme të De Radës ‘Milosao’ nga studentët e Katedrës së Letërsisë së Universitetit të Tiranës.	Tiranë
 03.06.2014	Shkodër	Konferencë shkencore në Universitetin e Shkodrës për veprën dhe kontributin e De Radës në rilindjen kombëtare dhe themelimin e poezisë shqipe.	Shkodër
 4-5.06.2014	Elbasan	Konferencë shkencore në Universitetin e Elbasanit për rëndësinë e jashtëzakonshme dhe ndikimin e rëndësishëm të De Radës në letërsinë tonë dhe vetëdijen artistike dhe kombëtare.	Elbasan
 5-7.06.2014	Pogradec	Konferencë shkencore që rrok tema të kulturës arbëreshe e organizuar nga Katedra e Shqipes në Universitetin e Mynihut	Pogradec



10.09.2014	Tiranë	Shpallja e konkursit kombëtar të esesë për të rinj nën moshën 21 vjeç ‘Unë Milosao’, e organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit	Tiranë
 Tetor 2014	Gjirokastrë	Promovimi i dy veprave të pabotuara më parë të De Radës dhe konferenca shkencore me tema të poetikës arbëreshe në auditorët e Universitetit “Eqerem Çabej “	Gjirokastrë
 Tetor 2014	 Tiranë	Botohet për herë të parë vepra e plotë e De Radës me komente nga Prof. Mateo Mandala dhe Prof. Francesco Altimari. Ky botim realizohet me kontributin e Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe sporteve të Kosovës.	Tiranë
 30.10- 03.11 2014	 Tiranë	Konferencë shkencore-përkujtimore me studiuës nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe arbëreshë të Greqisë dhe Italisë	Tiranë
 12.11.2014	 Tiranë	Promovimi i botimit të plotë të veprës së Jeronim De Radës që do të organizohet nga Ministria e Kulturës në Panairin e Librit	Tiranë
 23.11.2014	 Tiranë	Shpallja e fituesve të konkursit të esesë “Unë Milosao” në mjediset e Ministrisë së Kulturës	Tiranë

